

NEWSLETTER E DIASPORËS

PERFAQËSIMI DHE NXITJA E POLITIKAVE TË BASHKËPUNIMIT DHE NDËRVEPRIMIT ME TË GJITHË SHQIPTARËT,
DUKE NXITUR E FUQIZUAR BASHKËPUNIMIN NË TË GJITHA FUSHAT ME SHQIPTARËT JASHTË KUFIJVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHITETET KU ATA BANOJNË

#90

RAPORTIMI/ Agjencitë e Diasporës në Nënkomisionin e Diasporës dhe Migracionin: Puna e kryer dhe sfidat e ardhshme



Agjencitë përgjegjëse të Diasporës kanë raportuar punën e tyre gjatë vitit 2020 para nënkomisionit për Diasporën në Kuvendin e Shqipërisë. Në mbledhje u vlerësua se baza veprimit të institucioneve shtetërore për vitin 2021 do të jetë “Strategjia e re Kombëtare e Diasporës” 2021-2025 që hyn në fuqi më 1 janar të vitit të ardhshëm. Ministri i Shtetit për Diasporën ka raportuar në nënkomisionin parlamentar të Diasporës në Kuvendin e Shqipërisë lidhur me realizimet e institucionit të tij dhe agjencive në varësi përsa i përket ecurisë së punës përgjatë vitit 2020 dhe objektivave për vitin e ardhshëm.



Vota e Diaspores Shqiptare

Të interesuarit për të drejtën e votës në migracion mund të gjejnë propozimet që i janë dërguar Komisionit të Reformës Zgjedhore.

diaspora.gov.al/votim-dhe-rregjistrim

BOTIMI/ Cilat janë vendet që kanë marrëveshje për sigurimet shoqërore me Shqipërinë



Ministri i Shtetit për Diasporën Pandeli Majko gjatë raportimit për vitin 2020 në Nënkomisionin për Diasporën në Kuvendin e Shqipërisë tha se për shkak të situatës së krijuar nga pandemia e COVID-19 ka qenë i vështirë ecuria e procesit për marrëveshjet e pensione. I gjithë informacioni në lidhje me këtë çështje gjendet i plotë në revistën “Marrëveshjet Shtetërore në Fushën e Sigurimeve për Shtetasit Shqiptarë Jashtë Vendlindit” një botim i veçantë elektronik i Agjencisë Kombëtare të Diasporës i cili realizohet për herë të parë. Botimi i revistës lidhet me dhënien e informacionit të plotë për publikun për marrëveshjet ndërshtetërore të Republikës së Shqipërisë me shtetet pritëse të komuniteteve shqiptare për njohjen e ndërsjellët të kontributeve të sigurimeve shoqërore (për pensionet).



Rrjeti i Profesionistëve të Diasporës

është një platformë që synon të mbështesë e të nxisë transmetin e të dhënave profesionale duke ofruar një urë lidhëse me kapacitetet profesionale e ndryshme në Diasporë

rrjetiprofesionisteve.al

PUBLIKIMI/ Botohen për herë të parë raportimet vjetore të koordinatorëve



Revista informuese “Raportimi i Koordinatorëve Shtetëror-2020” është një botim i veçantë elektronik i Agjencisë Kombëtare të Diasporës.

Revista paraqet raportimet vjetore të Koordinatorëve Shtetërorë për vitin 2020 për çështje që kanë të bëjnë me fushën e tyre të përgjegjësisë në aplikimin e politikës shtetërore për Diasporën shqiptare.

Koordinatorët shtetërorë emërohen me urdhër të veçantë të Kryeministrit. Ata janë personat përgjegjës për koordinimin ndërinstitucional të çështjeve që mbulojnë.



Digjitalizimi

Veprat e autorëve të letërsisë shqiptare vijnë për herë të parë në formatin digjital falas për të gjithë shqiptarët kudo që ndodhen

adld.al

REMITANCAT/ BB nis takimet për rëndësinë e dërgesave të diasporës në vend




Banka Botërore organizoni pasditen e kësaj të premte takimin online me përfaqësues të Diasporës Shqiptare në Shtetet e Bashkuara mbi rëndësinë e remitancave të Diasporës. Ministri i Shtetit për Diasporën, Pandeli Majko i pranishëm në këtë event tha se tre janë prioritetet kyçe të institucionit që drejton përsa i përket temës së dërgimit të parave dhe shërbimet financiare të rëndësishme për diasporën. Në kuadër të projektit “Greenback” ministri Majko vuri theksin në rëndësinë e remitancave si një faktor zhvillimi të qëndrueshëm në Shqipëri. I pranishëm në panel Mahesh Uttamchandani, Menaxher i Praktikës Globale për Financa, Konkurrencë dhe Inovacion, në Grupin e Bankës Botërore, tha se dërgesat e emigrantëve janë një burim jetësor i rëndësishëm i financimit në shumë ekonomi në botë, shpesh duke tejkaluar ndihmën zyrtare të zhvillimit dhe investimet e huaja direkte.

Aplikacioni Gazeta "Diaspora Shqiptare"



App store: [këtu](#) Play store: [këtu](#)


REVISTA/ “Letra nga Diaspora” për autorët në mërgim



Qendra e Botimeve për Diasporën, e mbyll këtë vit të vështirë me botimin e numrit të parë të revistës letrare “Letra nga Diaspora”.

Ideja për revistën “Letra nga Diaspora” do të lindte natyrshëm gjatë zhvillimit të Takimit të parë të Shkrimtarëve nga Diaspora, të organizuar nga Qendra e Botimeve për Diasporën më 22 shkurt 2020, pak ditë para nisjes së karantinës globale të shkaktuar nga COVID-19.

“Raporto” problemin në çdo kohë në Ambasadalme



TAKIMI/ Strategjia për botimet shkencore të QSPA-së gjatë 2021-shit



Pas miratimit të raportit vjetor të Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët (QSPA) nga Nënkomisioni për Diasporën në Kuvendin e Shqipërisë, ditën e sotme u zhvilluan një takim në lidhje me reflektimin mbi këtë raport, si dhe ecurinë e punës së këtij institucioni kërkimor- shkencor.

Në këtë takim ishte i pranishëm Ministri i Shtetit për Diasporën Z. Pandeli Majko, drejtoresha ekzekutive e Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët (QSPA), prof. Diana Kastrioti, si dhe stafi akademik dhe administrativ i kësaj Qendre. Pas analizimit të rezultateve të arritura gjatë vitit 2020, u diskutuan pikat kryesore të planit të punës dhe strategjia për botimet shkencore gjatë vitit 2021.